



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/01-3523

Dt.03.10.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: Investitori N.N. "Arbri", me seli në Gjakovë, e regjistruar me numër të biznesit 70589060, të cilën e përfaqëson Z. Tunxhill Gjokaj nga fshati Dashinoc, Komuna e Deqanit, bazuar në Aktin Noterial – Kontratë për ndërtimin e përbashkët, me numër LRP nr. 2203/2017, REF.nr.553/2017, dt.16.05.2017, për dhënien e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt banimor shumë banesor, me afarizëm në përdhese, me etazhitet B+P+7, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, si dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 nenit 21, 44 dhe 97, bien këtë:

A K T V E N D I M

I. I LEJOHET: Fehmi (Ragip) Vula, Jeton (avni) Vula, Zeki (Ragip) Vula, Mehdi (Ragip) Vula, Masar (Ragip) Vula, Veton (Gani) Vula nga Gjakova, ndërtimi i objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt banimor shumë banesor, me afarizëm në përdhese, me Investor N.N. "Arbri", me seli në Gjakovë, e regjistruar me numër të biznesit 70589060, të cilën e përfaqëson Z. Tunxhill Gjokaj nga fshati Dashinoc, Komuna e Deqanit, bazuar në Aktin Noterial – Kontratë për ndërtimin e përbashkët, me numër LRP nr. 2203/2017, REF.nr.553/2017, dt.16.05.2017, Sipas Projektit Kryesor të prezantuar) në përputhshmëri me Planin Rregullues Urban të rrugës "Sadik Stavileci dhe Uçk", (me Vërejtjet e poshtëshënuara) Kushtet Tekniko Urbanistike, të datës 22.02.2011 të lëshuar nga DUMM, në ngastrën kadastrale me nr. 462/1, ZK: Gjakovë - Qytet, në pronësi të Fehmi (Ragip) Vula, Jeton (avni) Vula, Zeki (Ragip) Vula, Mehdi (Ragip) Vula, Masar (Ragip) Vula, Veton (Gani) Vula nga Gjakova, secili me nga 1/6 (pjesë ideale të pronës), në rrugën "UÇK", e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit në fjalë, etazhiteti i objektit është B+P+7, me sipërfaqe të përgjithshme (bruto) të objektit $S=5871.16 \text{ m}^2$

Bodrumi:	(Sip.Bruto):	$S=677.97 \text{ m}^2$
Përdhesa:	(Sip.Bruto):	$S=603.57 \text{ m}^2$
Kati i parë:	(Sip.Bruto):	$S=655.66 \text{ m}^2$
Kati i dytë:	(Sip.Bruto):	$S=655.66 \text{ m}^2$
Kati i tretë:	(Sip.Bruto):	$S=655.66 \text{ m}^2$
Kati i katër:	(Sip.Bruto):	$S=655.66 \text{ m}^2$
Kati i pestë:	(Sip.Bruto):	$S=655.66 \text{ m}^2$
Kati i gjashtë:	(Sip.Bruto):	$S=655.66 \text{ m}^2$
Kati i shtatë:	(Sip.Bruto):	$S=655.66 \text{ m}^2$

VËREJTJE: Kjo Leje Ndërtimore ipet me vërejtjet si më poshtë:

• Gjatë ndërtimit të objektit operatori do të operon përmes ngastrave fajnë me nr. 477/0 dhe 478/1, Sipas Aktit Noterial – Deklaratë nën betim, për të drejtën e kalimit, me nr.LRP.Nr.8849/2017, të datës 29.09.2017, dhe asnjë aktivitet ndërtimor (deponim dhe operim) nuk do të cenoj rrugën e përbashkët në bashkëpronësi të familjes Vula dhe familjes Lluka.

• Aplikuesi nuk do të pajiset me Certifikatë të Përdorimit deri në rregullimin e shpronësimit të Ngastrave për ekzekutimin e rrugës publike në përputhje me Planin Rregullues Urban të kompleksit urbanistik – potezi në mes të rrugëve "Sadik Stavileci dhe Uçk", bazuar në Deklaratën e Përbashkët për shfrytëzimin e rrugës së përbashkët, e Noterizuar me nr. LRP.Nr.8905/2017, dt.02.10.2017.

II. Hartimin e projektit me destinim: ndërtimi i objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt banimor shumë banesor, me afarizëm në përdhes, nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë ndërmarrja projektuese shërbyese “HARP” - Gjakovë.

III. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

IV. Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspektionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve:

V. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

N.N. “Arbri”, me seli në Gjakovë, e regjistruar me numër të biznesit 70589060, të cilën e përfaqëson Z. Tunxhill Gjokaj nga fshati Dashinoc, Komuna e Deqanit, në cilësinë e Investitorit bazuar në Aktin Notal – Kontratë për ndërtimin e përbashkët, me numër LRP nr. 2203/2017, REF.nr.553/2017, dt.16.05.2017, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351/01-3523, dt. 20.02.2017, për dhënien e Lejes së Ndërtimit, për ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt banimor shumë banesor, me afarizëm në përdhese, me etazhitet të objektit B+P+7, në ngastrën kadastrale me nr. 462/1, ZK: Gjakovë - Qytet, në rrugën “UÇK” siç është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:500, të datës 21.01.2011, të vërtetuar nga DUMM-Gjakovë.
2. Kopjet planit të datës 15.02.2017, në pronësi të Fehmi (Ragip) Vula, Jeton (avni) Vula, Zeki (Ragip) Vula, Mehdi (Ragip) Vula, Masar (Ragip) Vula, Veton (Gani) Vula nga Gjakova, secili me nga 1/6(pjesë ideale të pronës), të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Certifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme(fotokopje) me numër të lëndës 572/17, të datës 15.02.2017, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Lejen Urbanistike me nr. 07-351-8334/10, dt.27.05.2011, të lëshuar nga DUMM.
5. Kushtet Teknike - Urbanistike të datës 22.02.2011, për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit të banimor shumë banesor me afarizëm në përdhes, në ngastrën kadastrale me nr. 462/1, ZK: Gjakovë - Qytet, të lëshuar nga DUMM.
6. Raporti mbi kërkimet gjeomekanike në teren si dhe kërkimet laboratorike në lokacionin e parashikuar për ndërtimin e objektit afaristo banesor, në ngastrën kadastrale me nr. 462/1, të hartuar nga “Geomerkur” Sh.p.k.Gjakovë.
7. Lejen Mjedisore Komunale me nr. 07-351/2 - 18505, dt.22.09.2017, lëshuar nga DUMM.
8. Përfundimin nga Staf i DUMM, i datës 18.04.2011.
9. Pëlqimin Sanitar, me nr. 14/530/01-17801 të datës 14.08.2017, nga Inspektoriati Sanitar komunal-Drejtorja për Punë Inspektuese.
10. Pëlqimin për lokacion nga mbrojtje kundër zjarrit, me nr.02/12 me datë 22.03.2017, lëshuar nga Sektori i parandalimit dhe hulumtimit të zjarrit, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim.

11. Aktin Noterial – Kontratë për Ndërtimin e Përbashkët me numër LRP nr.2203/2017, REF.nr.553/2017, dt.16.05.2017.
12. Aktin Noterial - Deklarat nën betim, për të drejtën e kalimit, me nr.LRP.Nr.8849/2017, dt.29.09.2017.
13. Deklaratën e Përbashkët për shfrytëzimin e rrugës së përbashkët, e Noterizuar me nr. LRP.Nr.8905/2017, dt.02.10.2017.
14. Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë, numër 430-L-35 të datës 01.08.2017.
15. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, të datës 10.05.2011.
16. Pëlqimin nga K.R.U."Radoniqi"Sh.A.-Gjakovë, të dt.28.04.2017.
17. Pëlqimin nga PTK- Sh.A. Gjakovë, të datës 27.04.2011.
18. Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në Raiffeisen Bank, filiali në Gjakovë, të datës 12.09.2017.
19. Projektin kryesor në 3 (tri) kopje, i punuar ndërmarrja projektuese shërbyese "HARP" - Gjakovë.

Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 23679.41 Euro.

KËSHILLË JURIDIKE:


Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Aktvendimi i dorëzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë së Inspektionit ,
- Arkivit.

Zyrtar i Lartë për Çështje Juridike


Zenel Shabani, jur. i dipl.


U.D. Drejtori

Elida Bejtullahu, inxh. e dipl.e ark.




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT \ KOPIJA PLANA \ COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija \ Municipal Cadastral Office : GJAKOVË
Zona Kadastrale / Katastarska Zona \ Cadastral Zone : Gjakovë Qytet

Njësia \ Jedinica \ Unit	Tipi \ Vrsta \ Type	Sipërfaqja \ Poveršina \ Area m ²
P - 70705029 - 00462 - 1	Parcelë \ Parcela \ Parcel - arë	620.0
	Parcelë \ Parcela \ Parcel - oborr	500.0
	Parcelë \ Parcela \ Parcel - ndër	157.0



VËREJTJE

Kopja e planit i përdoret në mungesë të planit Original,
nga kopja e vjetër për parcelë kadastrale nr. 462-1.

Shkalla / Razmera / Scale: 1:500

Punoi \ Obradio \ Created :

Data \ Data \ Date : 15.09.2017

Koha \ Vreme \ Time : 14:23:15

Nënshkrimi \ Potpis \ Signature:

Shënim \ Beleška \ Note :

Aprovoi \ Usvojio \ Approved : Drejtori \ Direktor \ Director

Nënshkrimi \ Potpis \ Signature:

